

**SHPALLJE VETEM PËR NËPUNËS CIVIL,
PËR PROCEDURËN E KONKURIMIT KOMBËTAR**

**2 (dy) Inspektor i tatim taksave dhe menaxhimit të asetëve
Kategoria e pagës IV-a**

Në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe VKM Nr. 243, datë 18.03.2015 I “Për Pranimin, Lëvizjen Paralele, Periudhën e Provës dhe Emërimin në Kategorinë Ekzekutive”, i ndryshuar, Institucioni Bashkia Dimal shpall procedurën e konkurimit të hapur:

- **2 (dy) inspektor i tatim taksave dhe menaxhimit të asetëve**
- **Kategoria e pages IV-a**

Pozicionet më sipër, u ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga këto pozicione, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, ato janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet së pranimit nga jashtë shërbimit civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për

LEVIZJE PARALELE: 13.09.2021

Afati për dorëzimin e dokumentave për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL 17.09.2021

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Inspektori

1. Ndjek arkëtimin e taksave lokale për familjarët dhe tokës bujqësore sipas paketës fiskale;
2. Mban librin e taksave të tokës, sipas lagjeve dhe fshatrave nën juridiksionin e Bashkisë Urë Vajgurore;
3. Arkëton detyrimet e pasqyruara në libër me mandat arkëtimin përkatës dhe pajis familjarët me kartonin e taksave lokale;
4. Kryen regjistrimin e familjarëve të rinj , për taksa familjare dhe toke në librin përkatës;
5. Bashkëpunon me Drejtorinë e Planifikimit dhe të Bujqësisë për pasqyrimin e ndryshimeve të taksës së pasurisë dhe të tokës;
6. Rakordon në mënyrë mujore me zyrën e financës për arkëtimet mujore të debitorëve dhe të shumave totale sipas lagjeve dhe fshatrave;
7. Bashkëpunon me specialistin e taksave për rakordimet vjetore të taksave lokale dhe taksës së tokës;
8. Bën llogaritjen e taksës së tokës sipas kategorive të saj;
9. Në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, del me grupe pune për mbledhjen e taksave familjare dhe taksës së tokës;
10. Bën njoftimet për debitorët e të gjitha kategorive të taksave;
11. Respekton etikën në punë dhe me subjektet taksapaguese;
12. Zbaton detyrat që i ngarkohen nga Drejtori dhe Përgjegjësi i Zyrës;
13. Harton dhe plotëson librat e taksave lokale dhe të tokës për vitin e ri kalendarik;
14. Mbledh taksën e tregut të lirë (pazari i të premtes dhe i të shtunës) dhe e arkëton në arkën e Bashkisë,
15. Gjatë mbledhjes së taksave sipas natyrës së mallit, pajis çdo tregtar me biletën përkatëse dhe mban përgjegjësi për çdo neglizhencë;
16. Organizon sistemimin e tregut për një vendosje racionale e shfrytëzim sa më të mirë të sheshit për arkëtimin e të ardhurave;
17. Regjistron çdo ditë pazari në librin e tregut mandat arkëtimet;
18. Bën kontroll të numrit të tregtarëve dhe punon për rritjen e arkëtimeve;
19. Raporton për arkëtimet javore dhe mujore;
20. Merr pjesë në grupe pune të ngritura nga Drejtoria, harton proces-verbalet e ditëve të shiut;

21. Verifikon subjektet në terren, dhe merr pjesë ne grupe pune për bllokimin e aktivitetit te tyre;

1.1 KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mire”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë minimumi “Bachelor” *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*
- b) Përvoja e punës përbën avantazh.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 13 shtator 2021

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda datës 15 shtator 2021, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Institucionit Bashkia Dimal ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si dhe aktet lighore dhe nënligjore dalë në zbatim të tij.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar.
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/20151 “Kodi I Procedurave Administrative I Republikës Së Shqipërisë” I ndryshuar
- f) Njohuritë mbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, I ndryshuar
- g) Njohuritë mbi LIGJ Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore I Ndryshuar
- h) Njohuritë mbi VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 Për Metodologjinë Për Përcaktimin E Vlerës Së Taksueshme Të Pasurisë Së Paluajtshme “Ndërtesa”, E Bazës Së Taksës Për Kategori Specifike, Natyrën Dhe Prioritetin E Informacionit Dhe Të Dhënave Për Përcaktimin E Bazës Së Taksës, Si Dhe Të Kriterëve Dhe Rregullave Për Vlerësimin Alternativ Të Detyrimit Të Taksës, i ndryshuar
- i) Njohuritë mbi VKM Nr.783, datë 10.11.2011 Për Procedurat E Ndarjes Së Të Ardhurave Të Taksës Vjetore Të Mjeteve Të Përdorura Me Njësitë E Qeverisjes Vendore, i ndryshuar
- j) Njohuritë mbi Udhëzimin E Ministrisë Së Financave Nr. 32, datë 31.12.2013 Për Tatimin E Thjeshtuar Mbi Fitimin E Biznesit Të Vogël, i ndryshuar
- k) Njohuritë mbi Udhëzimin E Ministrisë Së Financave Për Përcaktimin E Uniformitetit Të Standarteve Procedurale Dhe Të Raportimit Nr. 655/1, Datë 06.02.2007 Të Sistemit Të Taksës Vendore, i ndryshuar
- l) Njohuritë mbi Udhëzimin E Ministrisë Së Financave Nr.1, datë 12.01.2007 Për Përcaktimin E Veprimtarive Që Trajtohen Si Veprimtari, Tregtare Apo Shërbimi, Ambulant Si Dhe Procedurat E Regjistrimit Të Tyre Në Organin Tatimor, i ndryshuar

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikimin pozitiv. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “ëëë.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të bashkisë si dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.

2- PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 21, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nepunesit civil”, i ndryshuar.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë minimumi “Bachelor” *Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*
- b) Përvoja e punës përbën avantazh.

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-Dokumente/219-udhezime-Dokumente>
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 17 shtator 2021, në Institucionin Bashkia Dimal.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil , do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Duke filluar nga data 17 shtator 2021 e deri më datën 27 shtator 2021, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Institucionit Bashkia Dimal, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi Ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”
- b) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 152/2013, “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore dalë në zbatim të tij.
- c) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- d) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 8503, datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i ndryshuar.
- e) Njohuritë mbi Ligjin Nr. 44/20151 “Kodi I Procedurave Administrative I Republikës Së Shqipërisë” I ndryshuar
- f) Njohuritë mbi Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, I ndryshuar
- g) Njohuritë mbi LIGJ Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore I Ndryshuar
- h) Njohuritë mbi VKM Nr. 132, datë 7.3.2018 Për Metodologjinë Për Përcaktimin E Vlerës Së Taksueshme Të Pasurisë Së Paluajtshme “Ndërtesa”, E Bazës Së Taksës Për Kategori Specifike, Natyrën Dhe Prioritetin E Informacionit Dhe Të Dhënave Për Përcaktimin E Bazës Së Taksës, Si Dhe Të Krieteve Dhe Rregullave Për Vlerësimin Alternativ Të Detyrimit Të Taksës, i ndryshuar
- i) Njohuritë mbi VKM Nr.783, datë 10.11.2011 Për Procedurat E Ndarjes Së Të Ardhurave Të Taksës Vjetore Të Mjeteve Të Përdorura Me Njësitë E Qeverisjes Vendore, i ndryshuar
- j) Njohuritë mbi Udhëzimin E Ministrisë Së Financave Nr. 32, datë 31.12.2013 Për Tatimin E Thjeshtuar Mbi Fitimin E Biznesit Të Vogël, i ndryshuar

- k) Njohuritë mbi Udhëzimin E Ministrisë Së Financave *Për Përcaktimin E Uniformitetit Të Standarteve Procedurale Dhe Të Raportimit Nr. 655/1, Datë 06.02.2007 Të Sistemit Të Takses Vendore*, i ndryshuar
- l) Njohuritë mbi Udhëzimin E Ministrisë Së Financave Nr.1, datë 12.01.2007 *Për Përcaktimin E Veprimtarive Që Trajtohen Si Veprimtari, Tregtare Apo Shërbimi, Ambulant Si Dhe Procedurat E Regjistrimit Të Tyre Në Organin Tatimor*, i ndryshuar

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë;

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike [ëëë.dap.gov.al](http://www.dap.gov.al)

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Institucioni Bashkia Dimal do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet.